



# Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

## NJOFTIM MBI SEANCËN E SHPALLJES SË VENDIMIT PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT ZNJ. ËNGJËLLUSHE TAHIRI



19/06/2023

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 16.6.2023, për subjektin e rivlerësimit, znj. Ëngjëllushe Tahiri bazuar në ligjin nr. 84/2016, vendosi:

Konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Ëngjëllushe Tahiri, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë.

Vendimi, i arsyetuar me shkrim, nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Brunilda Bektoshi, z. Lulzim Hamitaj relator, znj. Etleda Çiftja anëtare do t'i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall sot, në datën 19.6.2023.